



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr 8698/31 Prot.

Divjakë më 27/08 / 2025

RAPORT VENDIMMARRJE
I KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, MIRËQËNIES SOCIALE DHE BARAZISË
GJINORE

Komisioni i Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale të Këshillit Bashkiak Divjakë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Barazisë Gjinore të Bashkisë Divjakë për periudhën afatmesme. Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe bazës ligjore, komisioni thekson se ky plan është një instrument strategjik për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

Baza Ligjore ;Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri” i ndryshuar;- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar;- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË);- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 5: Barazia Gjinore).

Rëndësia e Planit,Plani i Barazisë Gjinore është një dokument politikash që synon:
- Të promovojë barazinë dhe përfshirjen gjinore në të gjitha fushat e jetës publike dhe private;- Të fuqizojë rolin e grave dhe vajzave në vendimmarrje lokale;- Të garantojë akses të barabartë në shërbime sociale, arsim, shëndetësi dhe punësim;- Të reduktojë diskriminimin dhe dhunën me bazë gjinore;- Të nxisë zhvillim të qëndrueshëm përmes pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave;- Të përafronte politikat vendore me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazi gjinore.

Përfundime dhe Rekomandime;Komisioni i Ekonomisë dhe Shërbimeve Sociale, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, bazuar edhe në degjese publike të realizuar për këto qellime, arrin në përfundimin se Plani i Barazisë Gjinore është një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Bashkisë Divjakë. Ky plan kontribuon në forcimin e rolit të gruas, rritjen e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët.

Në këtë kuadër, Komisioni i Shëndetësisë, i Mirëqënies Sociale dhe Barazisë Gjinore i propozon Këshillit Bashkiak Divjakë **miratimin në tërësi të Planit vendor të veprimit për Barazinë Gjinore.**

KOMISIONI I SHËNDETËSISË, I MIRËQËNIES SOCIALE DHE BARAZISË GJINORE

1.Ardian Vodo (kryetar)

2.Majlinda Xharo (zv.kryetar)

3.Elda Sinani (sekretar)

4. Alketa Çanaku (anëtar)

5. Bido Dermyshe (anëtar)

